



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 660/1 prot.

Tiranë, më 31.01.2020

VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 660/1, datë 31.01 2020


“MBI NDRYSHIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË OSHEE SH.A”

Mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr.43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”. VKM nr.317, datë 27.04.2016 “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë të sektorit të energjisë elektrike”, pikën c të nenit 13.2 të Statutit të shoqërisë OSHEE sh.a, Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.3, datë 06.01.2020 “Mbi miratimin e një ndryshimi në statutin e shoqërisë”, pas shqyrtimit të kërkesës bashkëlidhur shkresës tuaj nr.109/1prot., datë 06.01.2020, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë OSHEE sh.a,

VENDOSA:

1. Miratimin e Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.3, datë 06.01.2020 “Mbi miratimin e një ndryshimi në statutin e shoqërisë”.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë OSHEE sh.a, për ndjekjen e të gjitha procedurave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Belinda Balluku





KËSHILLI MBIKQYRËS
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A
TIRANË
VENDIM

Nr. 3 , datë 06.01.2020

“MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIM NË STATUTIN E SHOQËRISË”

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” i ndryshuar, ligjit Nr.43/2015 datë 30.04.2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.317, datë 27.04.2016 “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”, Këshilli Mbikëqyrës pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Administratori i shoqërisë, në mbledhjen e datës 06.01.2020,

VENDOSI:

- 1- Neni 1, paragrafi 1.1, i Statutit të Shoqërisë OSHEE sh.a. ndryshohet dhe bëhet si vijon:
Emri i Shoqërisë është “OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” (akronimi i të cilit shoqërohet gjithmonë me termin “Group” – “OSHEE GROUP”), i pasuar në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “Sh.A.”, që përfaqëson formën e saj ligjore, duke u referuar në vijim si “Shoqëria”.
- 2- Ngarkohet Administratori i shoqërisë OSHEE sh.a për paraqitjen e këtij vendimi për miratim pranë Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, për dërgimin e te dhënave sipas standarteve të kërkuara nga Ministria, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKQYRËS

ILIR BEJTJA

ARJANA DYRMISHI
ANËTAR

MATILDA KËRÇAKU

ANËTAR

XHOANA FLAGA
ANËTAR

ENEA KARAKACI

ANËTAR

SINDI DUSHKU

ANËTAR